



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0135

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " AGRO INVEST 1 " SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rehabilitimi dhe mirmbajtja e sistemit të kanalizimit dhe ujsjellësit në qytetin e Prizrenit dhe në fshatrat e Prizrenit” me numër të prokurimit ;622-23-11960-5-1-1, më, 11/04/2024, mori:

Vendim

1. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa e OE " AGRO INVEST 1 " SH.P.K. me nr. 2024/0135, e datës 16/02/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rehabilitimi dhe mirmbajtja e sistemit të kanalizimit dhe ujsjellësit në qytetin e Prizrenit dhe në fshatrat e Prizrenit” me numër të prokurimit; 622-23-11960-5-1-1, iniciuar nga AK/Komuna Prizren, pasi qe OE është palë pa interes juridik material në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 të LPP-së.

2. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës OE ankues " AGRO INVEST 1 " SH.P.K, sipas nenit 31.4 dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.10.2023, Komuna Prizrenit ,në cilësinë e Autoritetit kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Rehabilitimi dhe mirmbajtja e sistemit të kanalizimit dhe ujsjellësit në qytetin e Prizrenit dhe në fshatrat e Prizrenit” me numër të prokurimit 622-23-11960-5-1-1. Ndërsa me datën 01.02.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 2 500.000.00 €

Me 05.02.2024, OE " AGRO INVEST 1 " SH.P.K. ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim, kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 07.02.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE " AGRO INVEST 1 " SH.P.K. me nr. 2024/0135 lidhur me aktivitetin "Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit dhe ujsjellësit në qytetin e Prizrenit dhe në fshatrat e Prizrenit" me numër të prokurimit 622-23-11960-5-1-1.

- Faza e shqyrtimit paraprak -

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Në mbështetje të Rregullores 01/2020 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit gjegjësisht nenit 13 Dorëzimi i Ankesave paragrafi 9 i nenit 13 kërkohet që "Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues".

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE " AGRO INVEST 1 " SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) – Ankuesi pretendon se "arsyet e eliminimit të kompanisë sonë në letrën standarde nuk qëndrojnë sepse ne si OE i kemi ngarkuar të gjitha dokumentet e kërkuara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Ju si AK keni shkelur nenin 59 dhe 69 duke mos i respektuar kriteret e respektuara nga ju si AK dhe nenin 72 të LPP-së duke mos kërkuar asnjë informacion lidhur me dokumentacionin që ju pretendoni se nuk ekziston në Ofertën e ngarkuar nga ana jonë. Sa i përket parallogaritjes së gabuar njoftojmë se nuk ka gabime aritmetike në ofertën tonë financiare sepse ne si OE kemi ofertuar dhe kalkuluar çmimet në bazë të formulës që ju keni ngarkuar në sistem të e-prokurimit.

Pretendimi i dytë (II) - Ankuesi pretendon se "GOE konkretisht "Benita Company sh.p.k" dhe lideri i grupit N.T.P Qemal Krasniqi B.I", deklaratat nën betim është dokumentacioni i cili nuk plotësohet ashtu siç është paraparë me ligj. Në këto dy deklarata nuk është shënuar emri i OE dhe AK është dashur që të eliminoj nga ky aktivitet i Prokurimit.

Pretendimi i tretë (III) - Ankuesi pretendon se "OE i rekomanduar për kontratë konkretisht konzerciumi nuk është themeluar sipas rregullores për prokurim publik 001_2022 për prokurim publik. OE ankues thekson se kjo pikë nuk është plotësuar pjesërisht pasi nuk është cekur se operatorët nuk marrin pjesë në mënyrë individuale në tenderin e njëjtë por është cekur se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër në procedurën e njëjtë të prokurimit.

Pretendimi i katërt (IV) - Ankuesi pretendon se "Klasifikimi i këtij AP në fjalorin e përgjithshëm 50000000-5, ku dhe referencat për këtë AP duhet të jenë të ngjashme. Referencat të cilat janë prezantuar nga GOE i shpallur fitues nuk e arrijnë vlerën 3.5 milion siç është kërkuar në DT por arrijnë vlerën 1.084 milion kontrata "Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit të Ujsjellësit në Qytetin e Prizrenit.

Pretendimi i pestë (V) - Ankuesi pretendon se "GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar marrëveshje me ATK për shlyerje të borxheve e cila nuk është kërkuar nga AK si dhe disa vërtetime janë pranuar me

data të këtij viti ndërsa në njoftimin për kontratë është kërkuar deri në tre mujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.

Pretendimi i gjashtë (VI) - Ankuesi pretendon se “Inxhinieri i ujerave i certifikuar sipas EN805 Ë400 me dëshmi si CV-ja, referencat, diplomat si dhe certifikata e trajnimeve. GOE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur inxhinierin e Hidros, z.Besart Osmanaj me marrëveshje me firmën “Fortesa” sh.p.k. Kjo pikë nuk është plotësuar në tersi pasi inxhinierit i mungojnë referencat e punës.

-Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim -

Kërkesa juaj për rishqyrtim refuzohet si e pa bazuar për arsyet në vijim: Autoriteti Kontraktues ka ngritë te platforma e e prokurimit paramasat e formatit jostandard dhe të njëjtat ka mund ti shkarkoj, ti plotësoj dhe ti ngris në platformë çdo palë e cila ka shprehë interes për këtë projekt. Është obligim i OE që gjat ngritjes së ofertës si dhe para ngritjes së lidhjes së ofertës dhe qdo dokumenti tjetër, ta kontrolloj qdo dokument dhe pastaj ta ngrisë të oferta e vet. Ne në paramasa kemi dhënë përshkrimin e njërive, njësinë dhe njësinë matëse për secilën njësi. Në rekapitulim kemi dhënë edhe peshën e pozicioneve të ndarë në katër grupe dhe rubikën ku do të llogaritej nga ju çmimi i peshuar për njësi. nuk është e vërtet se oe tjerë pjesmarrës kan pasë tjera paramasa të cilat dallojnë nga ato që ju i keni shkarkuar. Ju gjat plotësimit të paramasave i keni peshuar dy (2) herë çmimet për njësi.” Oferta juaj është vlerësuar e papërgjegjshme edhe për faktet në vijim: Ju nuk keni referenca në vlere prej 3,500,000 Euro, Ju mungon Nje inxhinier i diplomuar ose master i ndertimtarisë i specializuar ne inixhinierin e ujrave si dhe i certifikuar sipas EN805, Ju mungon: Një inxhinier të diplomuar infrastrukture rrugore, Ju mungojnë 15 punëtorë të certifikuar. Ju keni gabuar edhe të llogaritja e çmimeve ku e keni bërë peshimin e çmimeve dy herë dhe për këtë arsye gabimin e çmimit të logaruar e keni mbi 2 %. Vlora e lexuar është 308.90 Euro e peshuar, ndërsa vlora e përmisuar është 1385.46 Euro e peshuar. Ju mongon: g. 1 cilindër nga 18-20 ton, h. kompresor ajri me terheqje me regjistrim valid, ll. makinë ngjeshese per montim ne eskavator me peshe 800 - 1000kg, n. Semafor mobil qift 12V90AH. Në ofertë tuaj nuk janë krijuar kushte për të kërku informata shtesë. Nuk qëndron asnjë pretendim i juaji lidhur me ofertat e OE të propozuar për kontratës nga se: edhe në procesin e rishqyrtimit të kërkesës tuaj nuk kemi gjet parregullsi të cilat ju i cekni në kërkesë.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 21.02.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0135 ndërsa me datë 07.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0135 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa rekomandon të anulohet aktiviteti i prokurimit.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është deklaruar se nuk pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertin shqyrtues duke theksuar “Komuna e Prizrenit në platformën e e-prokurimit ka ngritë paramasat e formatit JO STANDARD me këto të dhëna: 1. Emërtimi, 2. Njësia, 3. Sasia, 4. çmimi me TVSH për njësi, 5. Çmimi i peshuar. OE me rastin e shkarkimit të këtyre paramasave duhet që të plotësojnë këtë tabelarë në tërësi: a. japin çmimin për njësi, b. japin çmimin e peshuar sipas përqindjes së vendosur në këndin e djathtë te rubrika e fundit. Format i paramasave është JOSTANDARD andaj OE duhet që të kalkulojnë dhe të plotësojnë të gjitha rubrikat vet. Nëse ka formula të fshehta siç pretendon edhe eksperti, të gjitha ato duhet të pastrohen dhe OE nëse donë me ba kalkulimin me formula, i njëjti duhet të vendosë vet formulat siç kanë vepruar dy OE në këtë rast. Në Rekapitulim vendosin TOTALET e çmimeve për njësi të mbështetura në çmimet e dhëna për pozicione. Në rubrikën e çmimit të peshuar vendosen çmimet e peshuara sipas peshës së dhënë në secilin pozicion dhe në fund TOTALI i çmimit të peshuar. Kështu kanë vepru dy OE të cilët ne i kemi vlerësuar si të përgjegjshëm në këtë aspekt. Kurse OE ankues as nuk është mundu me kontrollu se çfar shifrash po vendos veq e ka ngjit paramasaën me shifra komplet GABIM. Në përgjigjen të cilen ia kam dhënë OE

ankues ia kam dërguar edhe tabelën se si do të duhej ta plotësonte i njëjti, dhe në total ka dalë se: Çmimi total për njësi i këtij OE është 9,138.10 euro. Çmimi i peshuar për njësi TOTALI është : 1,371,66 euro. Lus panelin që të marrë parasysh këto që i kam shënuar dhe nëse ka nevojë të thërras edhe seancë për ti shpjeguar në detaje këto të dhëna”. Po ashtu OE nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar “Ne lidhje me raportin e ekspertit shqyrtues me nr. te lendes 2024/0135, ne si Operator ekonomik ankues pajtohem vetëm me pjesën ku ankesa e jone aprovohet pjesërisht si e bazuar. Ndërsa lidhur me rekomandimin qe aktiviteti i prokurimit Rehabilitimi dhe mirembajtja e sistemit të kanalizimit dhe ujesjellësit në qytetin e Prizrenit dhe në fshatrat e Prizrenit me nr. të prokurimit 622-23-11960-5-1-1, te Anulohet ne si Operator Ekonomik i përgjegjshëm nuk pajtohem, pasi qe edhe ne pretendimet tona ankimore te paraqitura ne ankesën e datës 16.02.2024, kemi ofruar argumente te mjaftueshme qe dëshmojnë dhe vërtetojnë se ne si Operator Ekonomik kemi qene te PERGJEGJSHËM ne rastin e aplikimit ne këtë aktivitet te prokurimit Rehabilitimi dhe mirembajtja e sistemit të kanalizimit dhe ujesjellësit në qytetin e Prizrenit dhe në fshatrat e Prizrenit me nr. të prokurimit 622-23-11960-5-1-1. Andaj duke u bazuar ne te lartcekurat i kërkojmë Organit Shqyrtues te Prokurimit qe te caktoj seancën dëgjimore dhe ku ne si pale ankuese do te paraqesim pretendimet dhe argumentet tona te cilat do te vërtetojnë se ne si Operator Ekonomik kemi qene te Përgjegjshëm ne momentin e aplikimit dhe se Autoriteti Kontraktues neve na ka eliminuar pa te drejte nga aktiviteti e ku kemi qene ofertuesi me çmimin me te lire. Ndërsa lidhur me pretendimet se jemi eliminuar për arsye te aktivitetit politik te pronarëve të njëjtat i cekim ne seance para kolegjit e ne përgjigje te shkoj vetëm pjesa e lartcekur.

-Vlerësimi pretendimit ankimor të OE " AGRO INVEST 1 " SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës nr. 2024/0135 ka vlerësuar si në vijim:

Lidhur me pretendimin e parë ankimor të parashtruar nga OE ankues, Eksperti Shqyrtues sqaron se AK-ja ka ngarkuar në E prokurim Përshkrimin e çmimeve (paramasën) për këtë Aktivitet të Prokurimit. Paramasa është e rregulluar në atë formë (formulë) që plotësohet me çmimin e dhënë nga operatorët ekonomik dhe mbledhja e sasisë dhe çmimit llogaritet në bazë të formulës e cila duhet të jetë për të gjithë operatorët ekonomik. Eksperti Shqyrtues ka shkarkuar paramasën të cilën AK e ka ngarkuar në E prokurim dhe ka plotësuar me çmime të OE ankues dhe OE te rekomanduar për kontratë. Pas plotësimit të çmimeve të dhëna të OE ankues në Paramasën e ngarkuar në E-prokurim nga AK, rezulton se OE ankues nuk ka ndonjë gabim në llogaritje por janë çmime të ofruara sipas mënyrës së tij dhe të llogaritura sipas formulës e cila është në paramasën e AK-së, ndërsa në Plotësimin e çmimeve të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë në paramasën e ngarkuar në E prokurim nga AK, rezulton se këto çmime nuk rezultojnë me llogaritjen e njëjtë të formulës së paramasës së AK-së. Formula e paramasës së AK-së është: $Sasia \times shumëzim \text{ çmimi} \times shumëzim \text{ me } 15\%$. Shembull po paraqesim nga një pozicion për OE ankues dhe OE te rekomanduar për kontratë. Pozicioni 1.1; $Sasia = 1$, Çmimi i ofruar nga OE ankues 3000.00 dhe Çmimi total i 15% e pikëve për vlerësim është 450. Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë për pozicionin 1.1 ka ofruar si më poshtë. Pozicioni 1.1; $Sasia = 1$, Çmimi i ofruar nga OE ankues 30 dhe Çmimi total i 15% e pikëve për vlerësim është 30. Nga përshkrimi i dhënë si më lartë rezulton se llogaritja e çmimeve të OE i rekomanduar të plotësuar në paramasë nuk janë ofruar sipas formulës së paramasës së njëjtë me atë të cilën AK-ja e ka ngarkuar në e-prokurim. Eksperti shqyrtues, sqaron se Para masa e ofruar nga autoriteti kontraktues nuk lejohet te preken njësia matëse dhe sasi të e kërkuar, plotësohet vetëm pjesa e çmimit të ofruar nga ata, pastaj formula e bënë llogaritjen totale të çmimit të ofruar me sasi të e kërkuar nga AK-ja. Lista e çmimeve e kërkuar nga autoriteti kontraktues përbehet prej Fushave të mbyllura dhe fushat e hapura. Fushat e mbyllura janë Pozicioni, Njësia, Sasia dhe këto fusha nuk lejohet të ndërhyjnë nga operatorët ekonomik, ndërsa fushat e hapura siç janë çmimi njësi dhe vlera totale janë fushat ku Operatorët ekonomik duhet t'i plotësojnë. Andaj është përgjegjësi e zyrtarit të prokurimit dhe njësisë kërkuese të AK-së të hartoj apo përpiloj para masën dhe para llogarinë dhe në bazë të asaj para masë OE duhet ti paraqesin çmimet e tyre (ofertat financiare) duke mos ndryshuar nga Para masa e AK-së. Ndryshimi i kërkesave të paramasës nga OE nuk mund të llogaritet si gabim aritmetikor. Andaj, Eksperti Shqyrtues e sheh pretendimin ankimor si të bazuar për faktin se OE ankues ka plotësuar paramasën sipas paramasës së ngarkuar nga AK në e-prokurim, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë konkretisht në paramasën e këtij OE, llogaritja nuk është bërë sikurse është formula në

paramasën e ngarkuar në e-prokurim nga AK-ja. Eksperti Shqyrtues, sqaron se OE ankues është eliminuar edhe për disa pika tjera i cili në ankesën e parashtruar nuk ka provuar të argumentoj të kundërtën të cilën ia ka kumtuar AK-ja. Andaj, sipas Nenit 4 pika 1.26 i LPP-së dhe Njoftimit të OSHP-së të datës 09.02.2023, OE ankues nuk ka arritur të faktoj të gjitha arsyet e eliminimit të tij në letërën standarde për tenderues të eliminuar, andaj mbi bazën e të dhënave si më lartë OE ankues është palë pa interes juridiko-material.

Lidhur me pretendimin ankimor të dytë, në lidhje me mos plotësimin e deklaratave nën Betim nga OE i rekomanduar për kontratë, Eksperti Shqyrtues sqaron se OE “Benita Company sh.p.k” dhe “N.T.P Qemal Krasniqi B.I” kanë plotësuar deklaratat nën betim, fakti se deklaratat nën betim në fillim të saj nuk kanë të shkruar emrin e operatorit ekonomik kjo nuk mund të shërbej si arsyetim për të konsideruar OE si të pa përgjegjshëm për shkak se të dy operatorët ekonomik e kanë plotësuar tabelën në deklaratën nën betim ku janë të vendosura edhe emërtimi dhe të dhënat tjera të kërkuara në tabelë, andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa qëndrueshëm.

Lidhur me pretendim ankimor të tretë, Eksperti Shqyrtues sqaron se GOE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tyre ka prezantuar deklaratën për themelimin e konzerciumit, ku në dokumentin e quajtur marrëveshje ekskluzive nuk është theksuar që operatorët ekonomik (anëtarët e konzerciumit) nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale në procedurën e njëjtë të prokurimit, andaj eksperti shqyrtues e konsideron të bazuar pretendimin ankimor për faktin se marrëveshja për themelimin e konzerciumit nuk është plotësuar sipas Nenit 26 të Rregullores për prokurim publik më saktësisht pika b e Nenit 26 të Rregullores Për Prokurim Publik 001_2022.

Lidhur me pretendimin ankimor të katërt, eksperti shqyrtues sqaron GOE kanë prezantuar listën e kontratave të realizuar, ku kanë përfshirë edhe kontrata të natyrës së ngjashme, mirëpo nga dëshmitë e prezantuara nga të gjithë anëtarët e GOE të rekomanduar për kontratë, rezulton se nuk kanë arritur të dëshmojnë se kanë realizuar kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë 3.500 000.00 Euro, Andaj OE i rekomanduar për kontratë është dashur të cilësohet i pa përgjegjshëm, rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të pestë, eksperti shqyrtues sqaron se dokumentet e kërkuara tek kërkesat e përshtatshmërisë, janë dokumente që AK i kërkon nga OE i rekomanduar për kontratë, në rastin e tanishëm AK i ka kërkuar dhe dokumentet janë ofruar, edhe pse ka anëtar të konzerciumit të cilët kanë ofruar dëshmi se janë në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK, kjo nuk mund të shërbej si arsye për tu konsideruar i pa përgjegjshëm GOE për faktin se janë ofruar dëshmitë, andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin ankimor të gjashtë, eksperti shqyrtues sqaron se GOE të rekomanduar për kontratë ka prezantuar inxhinierin e ujerave z. Besart Osmanaj i cili ka marrëveshje me anëtarin e konzerciumit “FORTESA” sh.p.k, për të cilin është prezantuar kontrata e punës për kohë të caktuar, CV-ja, diplomë e noterizuar, Certificate e pjesëmarrjes e noterizuar, mirëpo mungojnë referencat të cilat janë kërkesë e DT-së, andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar për faktin se mungojnë referencat për inxhinierin e lartpërmendur.

Si përfundim, Eksperti Shqyrtues, pasi ka analizuar në tersi procedurën e Prokurimit dhe pretendimet ankimore të përfshira në ankesë vjen në përfundim se AK-ja nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së, andaj konform Nenit 43.5 pika b e Rregullores për Prokurim Publik, eksperti shqyrtues rekomandon të anulohet Aktiviteti i Prokurimit pasi OE janë të pa përgjegjshëm.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Paneli shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e provës raportit vetëm sa i përket konstatimit lidhur me palën pa interes juridik, si në vijim: *“Eksperti Shqyrtues, sqaron se OE ankues është eliminuar edhe për disa pika tjera i cili në ankesën e parashtruar nuk ka provuar të argumentoj të kundërtën të cilën ia ka kumtuar AK-ja. Andaj, sipas Nenit 4 pika 1.26 i LPP-së dhe Njoftimit të OSHP-së të datës 09.02.2023, OE ankues nuk ka arritur të faktoj të gjitha arsyet e eliminimit të tij në letrën standarde për tenderues të eliminuar, andaj mbi bazën e të dhënave si më lartë OE ankues është palë pa interes juridiko-material.”*

Në nenin 111 të LPP-së përcakton se kur duhet të meren masa OSHP-ja për një ankesë të dorëzuar.

Në paragrafin 1.5. dhe 1.8 përcaktohen ndër të tjera dy kritere që duhet përmbushur për tu shqyrtuar një ankesë e ato janë:

1.5.vërteton se parashtruesi i ankesës kualifikohet si “palë e interesuar” siç është përkufizuar kjo shprehje në nenin 4 të këtij ligji;

1.8.përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës në raste kur ankuesi përfshin pretendimin për kompensim.

Andaj Paneli shqyrtues bazuar në konstatimin e ekspertit shqyrtues që ankuesi është “Palë pa interes juridiko-material” nuk lëshohet në konstatimet e pretendimeve ankimore ndaj të rekomanduarit për kontratë për shkak se pala ankimore nuk ka provuar se është palë me interes dhe Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi i ofruar nga OE ankues sipas AK është i papërgjegjshëm në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, i njoftuar zyrtarisht nga AK me anë të letrës standarde për tenderuesin e eliminuar dhe me anë të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e tij nuk e provon të kundërtën dhe e atakon OE të rekomanduar për kontratë. Autoriteti kontraktues Komuna e Prizren, me datën 01.02.2024, përmes, B24 Letres Standarde për

tenderuesin e eliminuar e ka njoftuar ankuesin në mënyre të detajuar për mungesat e ofertës së tij me dëshmi dokumentare, se është administrativisht i papërgjegjshëm, përshkak se nuk i ka plotësuar kërkesat ;1,3,4,B dhe 8, të Dosjës së tenderit.

Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK-së lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, rrjedhimisht pasi që Paneli shqyrtues ka konstatuar ashtu sikurse AK, se ankuesi është i papërgjegjshëm (eliminuar) si dhe në bazë të vendimit të AK edhe letrave standarde OE është eliminuar edhe për shumë arsye tjera për të cilat as në kërkesë për ri-shqyrtim dhe as në ankesë nuk i ka paraqitur për ta mbrojtur përgjegjësin e tij , andaj edhe për Panelin Shqyrtues sikurse Eksperti shqyrtues ankuesi në këtë rast kualifikohet si pale pa interes interes juridiko-material sipas nenit 4.1.26 të LPP, ngase të njëjtit në asnjë rethanë nuk mund të jetë fitues potencial mbi bazën e ofertës tyre të kësaj kontrate publike.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj". Për këto raste të ngjashme OSHP më dt. 09.02.2023, ka publikuar në ueb faqen e saj "*Njoftim për Operatoret ekonomik*" se si do të trajtohen në rast se nuk respektohen këto parime dhe nuk mund ta kenë pastaj statusin e palës me interes.

Këtë vendim Paneli shqyrtues e mbështet edhe tek neni 31, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20. Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritot të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të nenit 111, të LPP. Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit të anekses dhe procedurës së prokurimit në kontekstin shpjegimeve si më sipër, ankuesin e cilëson si palë pa interes juridik material, ku nder të tjera paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 103 të LPP, sipas të cilit, "*Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 të këtij ligji*". Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin se ankesa hedhet e palejuar, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatorët ekonomik ankues, AGRO INVEST 1 " SH.P.K bazuar në nenin 31

par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të drejtë, pa diskriminim, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - " AGRO INVEST 1 " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: